




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.02.2015, mori:

V E N D I M



I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-3047/14, për z. Veton Nurkollari – Kryetar i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës të dyshuar për konflikt interesi lidhur me projektin e filmit dokumentar “Vatër”, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit. Projekti “Vatër” është nënshkruar para se z. Nurkollari të emërohej në pozitën e kryetarit të Këshillit Drejtues.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti me nr. AKK – 03-3047/14 për z. Veton Nurkollari - Kryetar i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës, i dyshuar për konflikt interesi lidhur me projektin e filmit dokumentar të titulluar “Vatër” në të cilin, sipas paraqitësit të rastit, ky projekt filmik financohet nga buxheti i Qendrës Kinematografike (QKK), është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (më tutje Ligji PKI).

Pas pranimit të informacionit sipas të cilit dyshohet për konflikt interesi në këtë rast, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informacione nga Qendra Kinematografike e Kosovës nga e cila ka marrë përgjigje se QKK ka përkrahur projektin e filmit dokumentar me titull “Vatër/Atdheu”, i cili realizohet nga Kompania N.Sh. “Punëtorja Filmike” ndërsa, nënshkruar i kontratës në emër të kompanisë është Jeton Jagxhiu. Në këtë kompani bashkëpronar është edhe Veton Nurkollari.



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.02.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-3047/14, për z. Veton Nurkollari – Kryetar i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës të dyshuar për konflikt interesi lidhur me projektin e filmit dokumentar “Vatër”, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit. Projekti “Vatër” është nënshkruar para se z. Nurkollari të emërohej në pozitën e kryetarit të Këshillit Drejtues.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti me nr. AKK – 03-3047/14 për z. Veton Nurkollari - Kryetar i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës, i dyshuar për konflikt interesi lidhur me projektin e filmit dokumentar të titulluar “Vatër” në të cilin, sipas paraqitësit të rastit, ky projekt filmik financohet nga buxheti i Qendrës Kinematografike (QKK), është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (më tutje Ligji PKI).

Pas pranimit të informacionit sipas të cilit dyshohet për konflikt interesi në këtë rast, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informacione nga Qendra Kinematografike e Kosovës nga e cila ka marrë përgjigje se QKK ka përkrahur projektin e filmit dokumentar me titull “Vatër/Atdheu”, i cili realizohet nga Kompania N.Sh. “Punëtorja Filmike” ndërsa, nënshkruar i kontratës në emër të kompanisë është Jeton Jagxhiu. Në këtë kompani bashkëpronar është edhe Veton Nurkollari.

Në bazë të të dhënave që Agjencia ka marrë nga Qendra Kinematografike ky projekt është nënshkruar me datë 14.09.2012 ndërsa Këshilli Drejtues i Qendrës Kinematografike është emëruar me datë 06.06.2014.

Në këtë rast, kontrata në mes të kësaj kompanie dhe Qendrës Kinematografike është nënshkruar para se z. Nurkollari të emërohej në pozitën e kryetarit të Këshillit Drejtues.

Mirëpo, kjo nuk do të thotë se në të ardhmen nuk mund të shfaqet konflikti "rast për rast" i interesit. Kjo mund të ndodhë nëse, z. Nurkollari, në kuadër të kompetencave të tij, vendosë për ndonjë çështje që në ndonjë mënyrë apo tjetër ka të bëjë me këtë projekt.

Pika 1 e nenit 13 të ligjit PKI përcakton se *"Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit"*.

Në këtë situatë, z. Nurkollari ka për obligim që ta bëjë deklarimin "rast për rast" të konfliktit të interesit dhe të tërhiqet nga vendimmarrja.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

